



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:263730

Datë: 18.03.2024

Numri i dokumentit: 05466754

KF.nr.43/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me zyrtaren ligjore Amire Jahiri, në kontestin tregtar-administrativ të paditësit “Migros Group” SH.P.K, me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Y.B., në rigjykim dhe rivendosje sipas Aktgjykimit K.DH.SH.II.nr. 938/22 të datës 17.01.2023, kundër të paditurës Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur sipas padisë së paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti – rivlerësim malli, vlerë kontesti 39,420.00 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit Y.B. dhe ne mungese te palës se paditur, me datë 14.03.2024, mori:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit “Migros Group” SH.P.K, me seli në Prishtinë, si e bazuar.
- II. ANULOHET Aktvendimi nr. 01.3.2.2/801 te datës 19.02.2019 , i Doganës së Kosovës dhe lënda kthehet në RISHQYRTIM dhe RIVENDOSJE.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A R S Y E T I M

Dhomat e Shkallës së Dytë të kësaj Gjykatë me Aktvendimit K.DH.SH.II.nr. 938/22 të datës 17.01.2023, e kanë prishë aktgjykimin A. nr. 840/19 të datës 21.04.2021 dhe lëndën e kanë kthyer në rigjykim dhe rivendosje dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 05.04.2019 ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, kundër Aktvendimit

nr.01.3.2.2/801 i datës 19.02.2019. Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se: mbetemi në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë si dhe shpjegojë se aktvendimi i shkallës së dytë, me të cilin ankesa e paditësit është aprovuar si e bazuar, i propozojmë gjykatës që në ri procedurë të gjeturat e vendimit të shkallës së dytë të mënjahen dhe kështu gjykata të nxjerrë aktgjykim të drejtë dhe të bazuar me ligj. Pasi që paditësi në kërkesë padi pretendon se e paditura pa të drejtë në procedurë të ripërtërirë ka detyruar që të bëjë pagesën e shumës së përgjithshme prej 39.420.00 €, mbi bazën e detyrimit të pagesës së taksës doganore. Paditësi ri konfirmon se e paditura përkatësisht sektori për kontroll pas importues pa të drejtë dhe në kundërshtim me vetë vendimin e Qeverisë së Kosovës për vendosjen e masës mbrojtëse, detyrimi i pagesës së taksës prej 10 % me ngarkesë të dy DUD-ave kontestues përshkruar në detaje në akt padi. Paditësja me të drejtë konsideron se obligimi për pagës të masës mbrojtëse është nxjerr në kundërshtim të drejtë për drejtë me vendimin e Qeverisë së Kosovës nr.01/74 datës 06.11.2018, respektivisht në kundërshtim me vendimin 01/76 të datës 21.12.2018, vendime këto të nxjerra nga Qeveria e Kosovës, pasi produkte e përshkruara në faturat gjeqëse dhe DUD-at përkatës janë përjashtuar nga detyrimi i pagesës së masës mbrojtëse, meqë të njëjtat janë brenda ndërkombëtare. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 17.06.2022 e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Aktvendimi i atakuar është marr komfor të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i kontestuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Ndërsa në seancën e shqyrtimit kryesor e njëjta nuk ka prezantuar. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik ka administruar provat dhe atë: aktvendimi 801/19.02.2019, ankesa e ushtruar në Doganë e datës 28.12.2018, aktvendimi 2018-596/2 i datës 24.12.2018, përgjigja në padi e datës 25.06.2020, vendimi nr.01/76 i datës 21.11.2018, marrëveshja e datës 11.12.2018, vërtetimi i pronësisë i datës 19.12.2018, përgjigja nga administrata doganore e Maqedonisë së Veriut nr.388/04.04.2019, EUR1 nr247273, nr.247274, kërkesa për verifikim të origjinës e datës 20.12.2018, kontrata e datës 12.11.2018 dhe 13.12.2018, vërtetimi i pronësisë i datës 21.12.2018, email-korrespondencat e Doganës.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi dhe seancë, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, deklarimeve në padi dhe përgjigje në padi, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestues fakti se Dogana e Kosovës me Aktvendimin nr.03.1.1-2018-569/2 të datës 24.12.2018, e ka obliguar këtu paditësin me detyrime doganore shtese në shumë prej 39.420.00 €. Jo kontestuese mbesin edhe faktet se kundër aktvendimit të lartcekur paditësi ka ushtruar ankesë pranë Doganës së Kosovës, e për të cilin ankesë Dogana e Kosovës me datën 19.02.2019, ka sjell Aktvendimin nr. 01.3.2.2/801, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar kërkesën e subjektin në procedurë, e kundër të cilit aktvendim paditësi me padinë e datës 05.04.2019, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ pranë kësaj gjykate.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Dogana e Kosovës në shkallë të dytë e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë këtu paditësit, të ushtruar ndaj aktvendimit nr.03.1.1-2018-569/2 të datës 24.12.2018 të Sektorit për Kontroll pas Importuese, si të pa bazuar. E paditura ka vlerësuar se Sektorit për Kontroll pas Importuese ka vepruar drejtë kur subjektin në procedurë e ka obliguar me detyrime doganore shtesë duke ndryshuar të dhënat në deklaratat unike doganore R-74985/18.12.2018 dhe R-74988/18.12.2018, me arsyetim se një gjë e tillë ka ardhur duke u bazuar në vendimin e Qeveris së Kosovës nr.01/76 i datës 21.11.2018, si dhe faktit që lëvizjen e importit të produktit që është importuar rregullisht nga Serbia dhe është marke e mirënjohur serbe, subjekti ka prezantuar një kontratë të lidhur në mes të subjektit AD Dijamant- Serbi dhe Vitaminka nga Maqedonia, në të cilën është cekur se AD Dijamant autorizon subjektin Vitaminka nga Maqedonia, për të prodhuar sasinë prej 195.840 Litra para datës 28.12.2018 duke përdorur markën tregtare serbe Dijamanti.

Tutje e paditura në vendimin kontestues ka theksuar se në nenin 3 të kësaj marrëveshje është specifikuar se Vitaminka mund të prodhojë këtë sasi dhe ta distribuoj vetëm tek subjekti Migros dhe atë vetëm për territorin e Kosovës, ndërkaq që Shtetit të Kosovës palët i referohen me emrin

“AP Kosovo i Metohija”, e që bie në kundërshtim me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.01/76 i datës 21.11.2011. Rrjedhimisht të subjekti ka tentuar që përmes një marrëveshje të lidhur me kompaninë “Vitaminka” të vë në lajthitje institucionet e Kosovës sa i përket origjinës së mallit dhe shmangies nga pagesa e taksës mbrojtëse 100%, të vendosura për mallrat serbe, ku siç edhe nga vet kontrata e prezantuar, respektivisht kjo marrëveshje është bere vetëm për mallin “Vaj luledielli Dijamant” që do të eksportohet për në Kosove për subjektin “Migros Group” SH.P.K.

Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadisë, në vështrim të nenit 44 të LKA-së. Nga aktvendimi i kontestuar shihet se ai përmban të meta të tilla, të metat e tilla konsistojnë në faktin se arsyetimi i vendimit kontestues përmban të dhëna të pamjaftueshme sa i përket konstatimit të drejtë dhe të saktë të gjendjes faktike, lidhur me origjinën e mallit kontestues nga shteti eksportues.

Gjykata nga aktvendimit kontestues ka gjetur se Sektori për Rishqyrtimin e Vendimeve-Dogana e Kosovës nuk e ka konstatuar drejtë gjendjen faktike ngase nuk ka vlerësuar drejtë të gjitha elementet sa i përket aplikimit të origjinës, pra duke mos dhënë sqarime lidhur me origjinën e mallit kontestues nga shteti eksportues, veprim ky i domosdoshëm për të ardhur deri tek zbatimi i masës mbrojtëse 10% e pastaj edhe 100% sipas vendimit të qeverisë nr. 01/76 të datës 21.11.2018, andaj, gjykata vlerëson se e paditura në rivendosje duhet të verifikoj përmes rrugëve zyrtare origjinën e mallit nga shteti eksportues, si dhe të deklarohet lidhur me praktikën e pranimit të dokumentacionit të tillë para dhe pas të këtij rasti, ndaj subjektit të njëjtë.

Duke pasur parasysh konstatimet e sipër cekura, Gjykata konkludon se në këtë kontest tregtar administrativ ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar. Andaj Gjykata e udhëzon të paditurën që në bazë të autorizimeve ligjore që ka me Kodin Doganor dhe të Akcizave 03/L-109, të nxjerr aktvendim të bazuar në dispozita ligjore dhe sipas gjendjes së vërtetuar faktike duke marrë për bazë edhe të konstatimet dhe vlerësimet e Gjykatës si më lartë, si dhe gjithashtu në ri-procedurë e paditura të vlerësoj të gjitha elementet lidhur me origjinën e mallit të këtu paditësit në raport me veprimet apo mos veprimet e tija të ndërmarra në procedurë administrative, sepse vetëm mbi bazën e një konstatimi të drejtë të gjendjes faktike mund të vijë deri tek zbatimi i saktë i të drejtës materiale.

E paditura në këtë shqyrtim gjyqësor ka prezantuar si provë: kërkesën për verifikim të origjinës të datës 20.12.2018, përgjigjen nga administrata doganore e Maqedonisë së Veriut nr.388/04.04.2019, si dhe EUR1 nr. 247273, nr. 247274, e të cilat dokumente – prova nuk janë trajtuar dhe vlerësuar nga e paditura në procedurë administrative.

Në këtë drejtim Gjykata e detyron organin e paditur Doganën e Kosovës në Prishtinë, që në ri procedurë të veprj sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se nuk janë vlerësuar në mënyrë të drejtë të gjitha faktet që kishin me ndikuar në vendosjen e drejtë të çështjes. Gjykata vendos për çështjen e kontestit tregtar-administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43 paragrafi 1 të LKA-se. Në bazë të këtij parimi, Gjykata e ka të pamundur të vendosë në mënyrë meritore në këtë kontest tregtar-administrativ për arsye se ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, andaj, e aprovon padinë e paditësit, anulon aktvendimin e kontestuar, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje me udhëzimet si më lartë që përveç trajtimit dhe vlerësimit të provave siç janë kërkesën për verifikim të origjinës të datës 20.12.2018, përgjigjen nga administrata doganore e Maqedonisë së Veriut nr.388/04.04.2019, si dhe EUR1 nr. 247273, nr. 247274, bazuar në mandatin e saj dhënë nga neni 82 I KDA-së të siguroj informata të reja përmes rrugëve zyrtare në kuptim të konstatimit të sakte dhe të drejtë të gjendjes faktike referuar origjinës së mallit.

Neni 7 Parag 1 dhe 3 i Ligjit për Procedurën Kontestimore Nr.03/L-006 parasheh se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë me të cilat konstatohen faktet e tilla, Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e vet në faktet dhe provat, lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia që të deklarohen”* Nga këto dispozitat Gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës ka vendosur konform nenit 64 të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata komfor dispozitave ligjore të nenit 43, par 1 dhe 2, e 46, par 1 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.43/2023 datë 14.03.2024

Zyrtare Ligjore
Amire Jahiri

Gj y q t a r i
Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.